



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 11.5.2023

Nr. 487

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**VLERËSIMIN E RAPORTIMEVE TË VEPRIMTARIVE ME KARAKTER PUBLIK TË DISA  
INSTITUCIONEVE, PËR PERIUDHËN 5 MAJ - 10 MAJ 2023**

Sot, më datë 11.5.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

**SUBJEKT:** Ministria e Kulturës  
Banka e Shqipërisë  
Bashkia Tiranë  
Bashkia Korçë  
Bashkia Bulqizë  
Bashkia Devoll  
Bashkia Rrogozhinë

**OBJEKTI:** Vlerësimi i raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve për periudhën 5 maj deri 10 maj 2023.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

Data: 11.5.2023 Nr. 487  
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 5 Maj - 10 Maj 2023”

## KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 5 maj deri më 10 maj 2023, në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike (shkresë+email), janë raportuar gjithsej 51 aktivitete, nga 16 institucione. Nga verifikimi paraprak rezulton se nga këto, 7 aktivitete të zhvilluara nga 7 institucione janë raportuar në tejkalim të afatit ligjor.

Për aktivitetet e raportuara në tejkalim të afatit ligjor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kryer shqyrtimin administrativ si vijon:

1. Ministria e Kulturës ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Event Homazh me rastin e ndarjes nga jeta të arkitektit Gani Strazimiri”*, raportuar në datën 5.5.2023 për t’u zhvilluar në datën 9.5.2023,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, vlerëson se Ministria e Kulturës nuk ka pasur mundësi të raportojë në kohë për këtë aktivitet për shkak se nuk është në cilësinë e organizatorit. Gjithashtu, për shkak të tematikës “homazhe për ndarjen nga jeta”, nuk përbën veprimtari publike me detyrim për raportim.

2. Banka e Shqipërisë, ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti *“Takim i Guvernatorit Sejko, me përfaqësues të shoqatave të bizneseve eksportuese”*, raportuar në datë 9.5.2023 për tu zhvilluar në datë 8.5.2023.

Banka e Shqipërisë nëpërmjet email-it të datës 11.5.2023 ka sqaruar se: *“aktiviteti “Takim i Guvernatorit Sejko, me përfaqësues të shoqatave të bizneseve eksportuese”, u kërkua nga përfaqësuesit e shoqatave të bizneseve eksportuese për shkak të rrethanave të krijuara veçanërisht gjatë ditëve të fundit nga dobësimi i monedhës evropiane, euro, kundrejt monedhës tonë kombëtare, lek, dhe u vendos të realizohej nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko për ti sqaruar këto grupe interesi. Në datën 5 maj kemi kërkuar asistencë me email në adresat tuaja [aktivitete@kqz.gov.al](mailto:aktivitete@kqz.gov.al); [denoncime@kqz.gov.al](mailto:denoncime@kqz.gov.al); [elvira.qaxholli@kqz.gov.al](mailto:elvira.qaxholli@kqz.gov.al), për shkak të pamundësisë së aksesimit të faqes për të raportuar këtë aktivitet. Asistenca juaj ka ardhur me email në datë 8, dhe ne e kemi publikuar në datën 9 pasi unë isha me një ditë leje datë 8.5.2023”*.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, nisur nga tematika e aktivitetit dhe të dhënat e raportuara, vlerëson se aktiviteti përbën një veprimtari

administrative në funksion të ushtrimit të detyrave të institucionit, që nuk ka detyrim për raportim.

3. Bashkia Bulqizë, ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
  - Aktiviteti “Inspektim rruge”, raportuar në datë 8.5.2023 për tu zhvilluar në datë 12.5.2023

Bashkia Bulqizë nëpërmjet email-it të datës 8.5.2023 ka sqaruar se: *“Kërkoj ndjesë, është një lapsus nga ana ime, pasi nuk e kam llogaritur si duhet afatin kohor duke qenë se nuk jam marrë unë me raportime dhe në këtë fushë jam e re. Aktiviteti do të shtyhet më datë 13.5.2023.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se Bashkia Bulqizë, ka kryer një gabim në llogaritjen e afatit gjatë raportimit në ndërfaqe dhe e ka shtyrë aktivitetin për në datë 13.5.2023, në respektim të afatit ligjor. Në të tilla kushte, vlerësojmë se nuk jemi para kundërvajtjes administrative.

4. Bashkia Devoll ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
  - Aktiviteti *“Me 25 të rinj dhe të reja nga gjimnazi i qytetit të Bilishtit, ku do të paraqesin krijimtarinë e tyre në lidhje me tematikën”*, raportuar në datë 8.5.2023 për t’u zhvilluar në datë 12.5.2023.

Rezulton nga ndërfaqja e raportimeve që ky aktivitet është raportuar dy herë, në datën 8.5.2023 me datë zhvillimi 12.5.2023 (në shkelje të afatit ligjor të raportimit) dhe datën 8.5.2023 me datë zhvillimi 15.5.2023, me po të njëjtat të dhëna (brenda afatit ligjor)

Bashkia Devoll nëpërmjet email-it të datës 8.5.2023 ka sqaruar se: *“Nuk janë dy aktivitete të ndryshme, është një i vetëm por për shkak të një lapsusi në raportim është shënuar gabimisht data 12. Saktësojmë se aktiviteti do të zhvillohet në datën 15.5.2023.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura në raportim, vlerëson se është kryer një gabim gjatë raportimit në ndërfaqe, dhe është riraportuar, në respektim të afatit ligjor, për tu zhvilluar me datën e saktë 15.5.2023.

Për sa më sipër, vlerësohet se nuk jemi para një kundërvajtje administrative.

5. Bashkia Korçë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti *“Kryetari i bashkisë do të ndajë çmimet në festivalin e 56-të të këngës për fëmijë”*, raportuar në datë 5.5.2023 për tu zhvilluar në datë 6.5.2023.

Bashkia Korçë nëpërmjet email-it të datës 9.5.2023 ka sqaruar se: *“Për shkak të kushteve të motit nuk ishte përcaktuar vendi i zhvillimit të këtij aktiviteti. Për këtë arsye Bashkia Korçë ju ka njoftuar me email për t’ju vendosur në dijëni (ka njoftuar me email-in e datës 5.5.2023)”*.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se për shkak të tematikës, veprimtaria nuk përbën veprimtari publike me detyrim për raportim.

6. Bashkia Rrogozhinë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti *“Prezantim me video, thirrje qytetarëve të ushtrojnë të drejtën e votës”*, raportuar në datë 8.5.2023 për tu zhvilluar në datë 5.5.2023.

Bashkia Rrogozhinë nëpërmjet email-it të datës 8.5.2023 ka sqaruar se: *“Përsa i përket datës së zhvillimit të aktivitetit, duket qartë që për shkak të një gabimi gjatë postimit kemi vendosur datën 5.5.2023, dhe në rrjetet sociale të kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë Z. Edison Memolla, nuk ka asnjë postim në lidhje me aktivitetin në fjalë. Duke qenë se ndryshimet nuk lejohen pas postimit në faqen zyrtare të KQZ-së, ju njoftojmë se aktivitetin e raportuar në datën 8.5.2023, do të zhvillohet në datën 12.5.2023.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura në raportim, vlerëson se Bashkia Rrogozhinë ka kryer një lapsus në hedhjen e të dhënave në ndërfaqen e raportimeve. Data e zhvillimit të aktivitetit është 12.5.2023, në respektim të afatit ligjor të raportimeve. Për këtë arsye, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mirëkupton Bashkinë Rrogozhinë dhe vlerëson se nuk jemi para kundërvajtjes administrative.

7. Bashkia Tiranë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti *“Mbledhje e Këshillit Bashkiak”*, raportuar në datë 6.5.2023 për tu zhvilluar në datë 10.5.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura në raportim, vlerëson se ky aktivitet është një veprimtari administrative funksionale e Bashkisë Tiranë, dhe nuk mbart detyrim për raportim.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, dispozitat e ligjit nr. 10279, datë 20.05.2012 “Për kundërvajtjet administrative”, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

## VENDOS:

1. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
2. Pushimin e procedimit administrativ ndaj institucioneve si vijon:
  - a. Ministria e Kulturës,
  - b. Banka e Shqipërisë,
  - c. Bashkia Bulqizë,
  - ç. Bashkia Devoll,
  - d. Bashkia Korçë,
  - dh. Bashkia Rrogozhinë,
  - e. Bashkia Tiranë.
3. Ky vendim t’u njoftohet palëve nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**